

STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “SEFERI ENTERPRISES” SHPK

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar:

“SEFERI ENTERPRISES” SHPK është themeluar nga ortaku, Z. OLSI SEFERI atësia Hysen, amësia Eglantina, i datëlindjes 18.07.1997 lindur në Tepelenë dhe banues në Tiranë Rr. Bill Klinton, Ndërtesa 31, Hyrja 1, Selitë, Farkë, Tiranë i indentifikuar me kartë indentiteti me Nr J70718054K, lëshuar nga autoritetet Shqiptare në datën 23.09.2015, me vullnet të lirë themelon Shoqërinë me përgjegjësi të Kufizuar: “SEFERI ENTERPRISES” SHPK

Themeluesi, i cili është madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar në përputhje me ligjin, hartojnë edhe statutin e Shoqërisë si më poshtë:

Përmbatje

<i>EMËRTIMI I SHOQËRISË</i>	- 2 -
<i>KREU I - Themelimi, Emri, Kohëzgjatja, Selia</i>	- 2 -
<i>Neni 1 - Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit</i>	- 2 -
<i>Neni 2 - Objekti</i>	- 2 -
<i>Neni 3 - Kohëzgjatja</i>	- 3 -
<i>Neni 4 - Selia</i>	- 3 -
<i>KREU II - Kapitali</i>	- 3 -
<i>Neni 5 - Kapitali Themeltar</i>	- 3 -
<i>Neni 6 - Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit</i>	- 3 -
<i>Neni 7 - Transferimi i Kapitalit</i>	- 4 -
<i>KREU III - Organet Vendimmarrëse dhe drejtuese</i>	- 4 -
<i>Neni 8 - Organi Vendimmarrës</i>	- 4 -
<i>Neni 9 - Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme</i>	- 5 -
<i>Neni 10 - Kuorumi</i>	- 5 -
<i>Neni 11 - Marrja e Vendimeve</i>	- 6 -
<i>Neni 12 - Përjashtimi nga e drejta e votës</i>	- 6 -
<i>Neni 13 - Administrimi</i>	- 7 -
<i>Neni 14 - Kompetencat e Administratorëve</i>	- 7 -
<i>Neni 15 - Përgjegjësitë e Administratorit</i>	- 8 -
<i>KREU IV - Viti Financiar-Ekspertët</i>	- 9 -
<i>Neni 16 - Viti Financiar</i>	- 9 -
<i>Neni 17 - Ekspertët</i>	- 9 -
<i>KREU V - Prishja-Riorganizimi i Shoqërisë</i>	- 10 -



Neni 18 – Prishja dhe Likuidimi.....	- 10 -
Neni 19 – Riorganizimi i Shoqërisë bashkimi-ndarja	- 10 -
Neni 20 – Baza Ligjore.....	- 11 -
Neni 21 - Mosmarrëveshjet	- 11 -

EMERTIMI I SHOQERISE

Emërtimi i shoqërisë është “SEFERI ENTERPRISES” sh.p.k

Shoqëria ushtron aktivitetin në bazë të legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë duke u mbështetur në Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare” i ndryshuar dhe si person juridik e zhvillon aktivitetin në përputhje me këtë legjislacion dhe me normat e këtij statuti. Ky statut hyn në fuqi pas regjistrimit në QKB.

- “Statuti” është Statuti i shoqërisë;

KREU I

THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot, më 03.Janar 2024, themeluesi ka krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin

“SEFERI ENTERPRISES“ SH.P.K.


Themeluesit e shoqërisë Z. OLSI SEFERI banues në Tiranë Rr. Bill Clinton, Ndërtesa 31, Hyrja 1, Selitë, Farkë,Tiranë.

Neni 2

Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm: Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit Shqiptar, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë por pa u kufizuar në:

Krijimin dhe mirëmbajtjen sisteme softuerike, duke ofruar nga konceptualizimi deri tek mirëmbajtja dhe përditësimi/përmirësimi i tyre gjithashtu dhe të gjithë etapat e ciklit të zhvillimit të softuereve/sistemeve, duke përfshirë analizimin, dizajnimin, projektimin, kodimin, testimin, dhe mirëmbajtjen, gjithashtu zhvillimin e sistemeve të komunikimit, sigurisë apo migrimit si dhe përmirësimin e sistemeve aktuale informatike - Ofrimin e licensave, qirave dhe shërbimeve me bazë abonimi për zgjidhjet softuerike apo sistemeve të tjera, zhvillimin e lojërave dhe platforma interaktive dixhitale për argëtim/edukim si dhe zhvillimin aplikacioneve mobile, web,



desktop, sistemeve industriale, embedded, zgjidhjeve të inteligjencës artificiale (AI) për të automatizuar dhe përmirësuar proceset dhe shërbimet e biznesit - Menaxhimi i Hardware-it: Angazhimi në blerje, shitje, import-eksport dhe logjistikën e pajisjeve teknologjike dhe kompjuterike - Menaxhimi i të Dhënave: Përpunimi dhe analizimi i të dhëna të mëdha (BIG DATA) për të nxjerrë insajte dhe për të përmirësuar vendimmarrjen - Dizajni UX/UI dhe Grafik: Ofrimin e shërbime të avancuara në dizajnimin e përvojës së përdoruesit (UX) dhe identitetit visual (UI) dhe shërbimeve të tjera kreative dhe realizime grafike - Përpunime audio-video (reklama, spote, dokumentar) - Kryerjen e kërkimit dhe zhvillim (Research & Development) për të prodhuar zgjidhje të avancuara në fushën e teknologjisë informatike dhe softuerit - Ofrimin zgjidhjeve outsourcing për profesionistët e teknologjisë, duke u shtrirë globalisht - Menaxhimi dhe realizimin e evente korporative, promovuese dhe konferenca, me një theks të veçantë në teknologji – Implementimin e strategjive e marketingut inovativ, përfshirë hulumtimin e tregut dhe matjen e opinionit publik, grumbullimin e të dhënave dhe statistikave (sondazhe, testimin e tregut) - Investimin në pasuritë të luajtëshme dhe të paluajtshme - Investimin në tregun e bursës brënda dhe jashtë vendit – Kryerjen e transaksioneve tregtare, me pasuri dhe financiare, vendosjen e garancisë apo kryerjen e çdo transaksioni tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për përmbushjen e objektit të Shoqërisë - Themelimin apo zotërimin në pjesëmarrje, bashkëpunimi, lidhje e marrëveshjeve joint-venture apo të marrëveshjeve të ngjashme me shoqëri që kanë objekt të njëjtë apo lidhur me objektin e saj.

Neni 3 Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë: për një afat të papërcaktuar.

Neni 4 Selia

Selia e shoqërisë do të jetë në Tiranë Rr. Bill Klinton, Ndërtesa 31, Hyrja 1, Selitë, Farkë, Tiranë

KREU II KAPITALI

Neni 5 Kapitali themeltar

(1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100000.00 Lekë. Kapitali i shoqërisë ndahet në 1(një) kuote, Zoterohet nga ortakut që themeluan këtë shoqëri kuotave edhe Z. OLSI SEFERI me 100% të kuotave.

Kontributi i ortakut mund të jetë në para të cilat janë paguar plotësisht dhe menjëherë.

Neni 6 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

- 3 -



Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakut në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7 Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 8 Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:



- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9 **Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10 **Kuorumi**



Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “ Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare “, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11 Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos më tri të katërtat e votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :


- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 12 Përgjithshmi nga e drejta e votës

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votes nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimit në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;



ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

2. Kur ortakut përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortakut, të cilin përfaqëson.

Neni 13 Administrimi

(1) Asambleja e përgjithshme emëron Z. OLSI SEFERI si administrator të shoqërisë. Afati i emërimit është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi I administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

(2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administrator të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërimi bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.


Neni 14 Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë dhe detyre të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nën shkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, I paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtar edhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblesën e Përgjithëshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk I mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.



-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15 Pergjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;


c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.



4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

KREU IV

VITI FINANCIAR-EKSPERTËT


Neni 16 **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përrjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor, sic është i përcaktuar nga ligjet për SH.P.K në fuqi (9901) dhe ligji për kontabilitetin dhe VKM e udhëzimet përkatëse.

Neni 17 **Ekspertet**

Eksperti financiar për pasqyrat financiare zgjidhet nga asambleja e ortakëve nga lista e ekspertëve financiar të IEKA.

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tilla i ngarkuar nga ana e ortakëve.



Në përfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollët periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

KREU V

PRISHJA-RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 18 **Prishja dhe likuidimi**

Shpërndarja ose prishja e shoqërise mund të behet në çdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese së Ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;

Ne këtë rast Ortakët merrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “ Shoqëri në likuidim e sipër “.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

Nëse Ortakët nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 19 **Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Asamblese së Përgjithshme të Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”



Neni 20
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 21
Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

ORTAKËT

E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"SEFERI ENTERPRISES" SHPK

OLSI SEFERI

OLSI SEFERI
